



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:268233

Datë: 27.07.2020

Numri i dokumentit: 01040140

C.nr.1012/11

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i përgjithshëm, me gjyqtaren Shpresa Veselaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.A. nga Prishtina, rr. "S.V.", H. Nr. ..., në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me prokurë Armend Krasniqi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me prokurë B.M., për kompensim dëmi, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur në prani të palëve ndërgjyqëse, me datën 13.07.2020 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I- APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit M.K. nga Prishtina dhe **DETYROHET** i padituri Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë që paditësit t'ia kompenzoj dëmin material në shumë prej 549.00 € të shkaktuar për shkak të privimit pa bazë nga liria me caktimin e arrestit shtëpiak prej dt. 12.03.2007 deri me 12.06.2007.

II- REFUZOHET SI E PA BAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit mbi shumën e gjykuar nga paragrafi paraprak prej 549.00 € deri 812,174.87 €.

III. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit M.K. nga Prishtina dhe **DETYROHET** i padituri Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë që paditësit t'ia kompenzoj dëmin jomaterial në emër të dhimjeve shpirtërore në shumë prej 5,500.00 € për shkak të privimit të kunderligjshëm nga liria me caktimin e arrestit shtëpiak prej dt. 12.03.2007 deri me 12.06.2007.

IV. REFUZOHET SI E PA BAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit mbi shumën e gjykuar nga paragrafi paraprak prej 5,500.00 € deri me 1,100,000.00 €.

Mbi shumat e gjykuara nga paragrafi 2 dhe 3 të dispozitivit të këtij aktgjykimit, detyrohet i padituri që paditësit t'ia paguaj kamatën sikundër mjetet e deponuara në bankat komerciale në kursimet e qytetarëve mbi 1 vit pa destinim të caktuar, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive.

-e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

V- Secila pale i bart shpenzimet e veta te procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi ngeli në tërësi pranë padisë, parashtesës mbi precizimin e kërkesëpadisë të dt. 12.02.2020 dhe pretendimeve të theksuara nga seancën e shqyrtimit kryesor, me propozimin që të pranohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e bazuar si për nga baza dhe lartësia. Më tej ka shtuar se me Vendimin e Këshillit drejtues të K... sh.a. me seli në Prishtinë, Nr. 2/4048 i dt. 03.12.2003 paditësi është caktuar Drejtor gjeneral në K... Me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë PPH.nr.59/07 i dt. 12.03.2007 paditësit i është caktuar arresti shtëpiak në kohëzgjatje prej 1 muaj, duke filluar prej dt. 12.03.2007 për veprën penale “dështimi i raportimit të transaksioneve nga neni 10 par. 5 nënpar. a) dhe b), “pranimi i paligjshëm i kontributeve” nga neni 10 par. 8 dhe “pastiami i parave” nga neni 10 par. 2 i Rregullores së UNMIK-ut 2004/2. Ndërsa, me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Kp.nr.104/2007 i dt. 11.04.2007 paditësit i’ka vazhduar masën e arrestit shtëpiak edhe për 2 muaj, deri me dt. 12.06.2007. Me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut P.nr.504/2007 i dt. 12.02.2010 paditësi është shpallur i pafajshëm. Andaj i ka propozuar gjykatës që të detyrohet i padituri që për shkak të arrestit shtëpiak paditësit t’ia paguajë në emër të dëmit material shumë prej 812,174.87 €, ndërsa në emër të dëmit jo material, si pasojë e shkakimit të dhembjeve shpirtërore shumë prej 1,100,000.00 € (një milion e njëqind mijë euro) për periudhën nga dt. 01.12.2007 deri në marrjen e aktgjykimit, të gjitha këto me kamatë ligjore.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar: për përpilimin e padisë 208.00€, për precizimin e kërkesë padisë 104.00€, për dërgimin e prarashtrësave 200.00€, për shpenzimet e ekspertizës financiare 500.00€, për ekspertizën e psikiatrisë 150.00€, për taksën gjyqsore 500.00€, për 2 seanca gjyqsore 416.00€, e në shumë të përgjithshme prej 2,078.00€.

Përfaqësuesi i të paditurës ngeli në tërësi pranë përgjigjes në padi të dt. 08.04.2019 dhe pretendimeve të theksuara në seancat gjyqësore. Më tej ka shtuar se nuk e kundërshton bazën e kompensimit të dëmit jo material për periudhën prej 92 ditëve dhe atë prej dt. 12.03.2007 deri më dt. 12.06.2007, ndërsa kompensimin e dëmit material për periudhën prej dt. 01.10.2007 deri në ditën e mbatjes së shqyrtimit kryesor, e ka kundërshtuar si për nga baza ashtu edhe lartësia, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata për të vërtetuar bazueshmërinë e padisë dhe kërkesëpadisë, si dhe gjendjen e plotë të fakteve, e për të vendosur drejtë në këtë çështje juridike kontestimore, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur me dt. 13.07.2020, bëri administrimin e provave si në vijim:

Kontrata e punësimit e paditësit e lidhur me punëdhënësin K... e dt. 22.01.2002; Çeku për pagesën e pagës; Vendimi i periudhës gusht, tetor 2006; Vendimi i K... me nr.2/4048 i dt. 03.12.2003 për caktimin në pozitën e drejtorit të K...ës; Vendimi i K... me të cilin paditësit i është pushuar mandati i drejtorit gjeneral nga procesverbali i dt. 13.03.2007; Shkresa nga K... lidhur me njoftimin e paditësit për skadimin e mandatit të Drejtorit gjeneral të dt. 27.11.2007; Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.504/07 i dt. 12.02.2010; Procesverbali i dt.

12.03.2007 i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë; Aktvendimi KP.nr. 104/2007 i dt. 11.04.2007; Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me KP.nr.212/2007 i dt. 16.07.2007; Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.504/07 i dt.12.02.2010; Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës AP- KZH- 214/2010 i dt. 12.01.2012, me të cilën është vërtetuar pjesërisht Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr. 504/07 i dt. 12.02.2010, me të cilin paditësi është shpallur i pafajshëm; Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr. 212/2016 i dt. 07.11.2016; Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr. 212/16 i dt. 19.12.2016 lidhur me korrigjimin e Aktgjykimit Rev.nr.212/16 i dt. 07.11.2016; Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë KP.nr. 283/2007 i dt. 07.09.2007; Aktgjykimi C.nr.1925/13 i dt. 10.02.2014 dhe Ac.nr.3349/2014 i dt. 26.04.2016; Vërtetimi nga divizioni financiar i N... Bank i dt. 19.12.2011 Qarkullimi financiar në emër të paditësit nga dt. 01.07.2007 deri më dt. 29.07.2008; Ekspertiza financiare e dt. 31.10.2019 dhe plotësimi i ekspertizës financiare e dt. 18.02.2020 të punuara nga ekspertja financiare G.Sh.; si dhe Ekspertiza e psikiatrisë e punuar më dt. 15.07.2019 nga ekspertja e psikiatrisë Dr. N.M.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara një nga një dhe të gjitha së bashku me kujdes dhe ndërgjegje, sipas dispozitës së nenit 8 të LPK- së, gjykata gjeti se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Nuk është kontestuese se me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut P.nr.504/2007 i dt. 12.02.2010 paditësi është shpallur i pafajshëm.

Nga provat e administruara dhe faktet e vërtetuara gjykata gjeti se paditësi M.K.me Vendimin e Këshillit drejtues të K... sh.a. me seli në Prishtinë Nr. 2/4048 i dt. 03.12.2003 është caktuar Drejtor gjeneral në K... me mandat 4 vjeçar.

Gjyqtari ndërkombëtar i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me Aktvendimin PPH.nr.59/07 i dt. 12.03.2007 paditësit i'a ka caktuar arrestin shtëpiak në kohëzgjatje prej 1 muaj, duke filluar prej dt. 12.03.2007 për veprën penale "dështimi i raportimit të transaksioneve" nga neni 10 par. 5 nënpar. a) dhe b), "pranimi i paligjshëm i kontributeve" nga neni 10 par. 8 dhe "pastrimi i parave" nga neni 10 par. 2 i Rregullores së UNMIK-ut 2004/2. Ndërsa, me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Kp.nr.104/2007 i dt. 11.04.2007 paditësit- të pandehurit i ishte vazhduar masa e arrestit shtëpiak edhe për 2 muaj, e cila do të zgjat deri me dt. 12.06.2007.

Sipas shkresës së K... e dt. 27.11.2007, paditësit i ka skaduar mandati 4 vjeçar me dt. 28.11.2007. Me këtë shkresë është saktësuar që sipas nenit 46 par. 1 të Statutit të Bankës, Drejtorit Gjeneral- tani në cilësinë e paditësit, i ka pushuar mandati- pas skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhur.

Prej datës së caktimit të arrestit shtëpiak me dt. 13.03.2007, paditësit i kanë takuar të ardhurat personale prej 75% deri me dt. 30.11.2007, derisa i ka zgjatur mandati i Drejtorit gjeneral.

Sipas Aktgjykimit të gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 1925/2013 i dt. 10.02.2014 paditësit K...- N... Bank sh.a. i'a ka paguar pjesën e papaguar prej 25%, për periudhën prej 13.03.2007 deri me 13.11.2007, si pjesë e pagesës neto në shumë prej 8,195.12 €. Ky aktgjykim është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.3849/2014 i dt.

26.04.2016. Po kështu këtë aktgjykim Gjykata Supreme e Kosovës e ka vërtetuar me Aktgjykimin Rev.nr.2012/2016 i dt. 07.11.20016.

Nga provat e administruara dhe faktet e vërtetuara gjykata gjeti se me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 1925/13 i dt. 10.02.2014, është hedhur si e palejuar kërkesëpapia e paditësit me të cilën ka kërkuar të vërtetohet se paditësi te K...- N... Bank është në marrëdhënie pune dhe ka kërkuar që të kthehet në punë. Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ac.nr.3349/14 i dt. 26.04.2016.

Ndonëse objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit ishin pretendimet e paditësit që sipas parashtresës për rregullimin e kërkesëpadiisë i dt. 12.02.2010, me të cilën ka kërkuar që i padituri KGJK t'ia kompenzon dëmin material, si pasojë e ndërprerjes së punës të paditësit në shumë prej 812,174.87€, por gjykata gjeti se një kërkesë e tillë është e pabazuar, e papranueshme, madje edhe e kundërligjshme. Kjo pikërisht për arsye se sipas Aktgjykimit Rev.nr.212/2016 i dt. 07.11.2016 vërtetohet se paditësit në tërësi i është paguar paga, sipas Vendimit të Këshillit drejtues të K... sh.a. me seli në Prishtinë Nr. 2/4048 i dt. 03.12.2003, duke filluar prej caktimit të tij me dt. 13.03.2003 Drejtor Gjeneral e deri me dt. 30.11.2007, për sa kohë ka qenë në këtë post.

Sipas dispozitës së nenit 158, 185 dhe 189 të LMD-së i vitit 1978, ligj i cili aplikohet në rastin konkret, parashikohet që për sajimin e përgjegjësisë juridike për kompensimin e dëmit duhet të përmbushen 4 kritere juridikisht të barasvlefshme dhe atë: ekzistimi i dëmit, përgjegjësia apo fajësia për ekzistimin e dëmit, veprimi i kundërligjshëm dhe lidhja kauzale në mes të veprimit dhe pasojës së shkaktuar.

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 1925/13 i dt. 10.02.2014 është hedhur si e palejuar kërkesëpapia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se ai është në marrëdhënie pune dhe të kthehet në punë. Pra në rastin konkret duke qenë se paditësit i ka skaduar kohëzgjatja sipas kontratës deri me 30.11.2007, ndaj edhe nuk ekziston baza juridike për të kërkuar kompensimin e dëmit material. Përderisa paditësi ka ushtruar funksionin e Drejtorit gjeneral, atij edhe i janë paguar ato paga. Përpos kësaj me këtë aktgjykim paditësit i është refuzuar kërkesëpapia e tij, me të cilën ka kërkuar që e paditura N... Bank t'ia paguaj pagat e perealizuara për periudhën prej dt.01.12.2007 deri me dt. 31.12.2011.

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykimin C.nr. 1925/13 i dt. 10.02.2014 i'a kishte pranuar paditësit dëmin material në formë të fitimit të humbur në shumën prej 8,185.12 € për periudhën deri sa ishte në arrest shtëpiak, prej dt. 13.03.2007 deri me dt. 30.11.2007 prej 25%, duke qenë se paditësit pjesën tjetër prej 75 % i'a ka paguar N... Banka ku paditësi ishte caktuar si Drejtor gjeneral. Kjo formë e kompensimit të dëmit material në formë të fitimit të humbur i është caktuar sikur paditësi- i dëmtuari të kishte punuar në kohën e privimit nga liria.

Në bazë të gjendjes së tillë të çështjes i padituri nuk i'a ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit M.A. dhe se me asnjë veprim të kundërligjshëm atij nuk i ka shkaktuar dëm, si dhe nuk ekziston lidhja kauzale në mes të veprimit të paditurit KGJK dhe pasojës së shkaktuar. Prandaj dhe gjykata i'a refuzoi kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar që i padituri t'ia kompensoj dëmin material si pasojë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës mbi shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ndonëse bëri shqyrtimin dhe vlerësimin e Ekspertizes akuaristike- fainaciare e dt. 31.10.2019 dhe Poltësimin e Eekspertizës financiare e dt. 18.02.2020, të punuar nga ekspertja G.Sh., por gjykata gjeti se kjo ekspertizë me poltësimin e të njejtës, nuk është hartuar sipas rregullave të shkencës dhe profesionit të kësaj lëmie, me ndershmëri, ndërgjegjshmëri dhe

përgjegjësi profesionale, e sipas detyrave që dalin nga aktvendimi i kësaj gjykate me nr. veprues C.nr. 1012/11 i dt. 20.05.2019. Pikërisht për këto shkaqe dhe arsye gjykata konsideron se kjo ekspertizë me plotësim nuk mund të cilësohet si provë e përshtatshme për t'a mbështetur aktgjykimin në te.

Me përgjigjen në padi e dt. 08.04.2019 e paditura i'a ka pranuar paditësit shumën e gjykuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Kjo për faktin se sipas dispozitës së nenit 321 par.2 të LPK-së pala e paditur e ka pranuar atë shumë të gjykuar në vlerë prej 549.00 €.

Nuk është kontestuese se paditësit me privimin e kundërligjshëm nga liria, me caktimin e arrestit shtëpiak sipas Aktvendimit PPH.nr.59/07 i dt. 12.03.2007, i vazhduar me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Kp.nr.104/2007 i dt. 11.04.2007, paditësit i është shkaktuar dhimbje psiqike e intenzitetit të lartë në kohëzgjatje prej 3 muajve, për shkak të cënimit të lirisë së lëvizjes. Me rastin e shqiptimit të këtij lloji të dëmit në shumën e gjykuar gjykata pati para syshë të gjitha rrethanat e kësaj çështje juridike siç janë: prestigji si Drejtor i K...-ës, pesha dhe natyra e veprës penale që i është vënë në barrë, kohëzgjatja e privimit nga liria si dhe intenziteti i dhimbjeve psiqike.

Në caktimin e lartësisë së kompensimit të drejtë të dëmit jomaterial ka ndikuar fakti që paditësi ka dështuar që të kërkoj nga gjykata në procedurë penale shpalljen publike që paditësi është privuar nga liria në mënyrë të kundërligjshme.

Po ashtu me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jomaterial si dhe për lartësinë e këtij shpërblimi, gjykata ka pasur para syshë edhe rëndësinë e cënimit të së mirës që ka të bëj me kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe sidomos qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim. Përpos kësaj me rastin e caktimit të lartësisë së këtij shpërblimi ashtu siç është caktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, gjykata pati para syshë që i njëjti të mos favorizoj synimet që nuk janë në pajtim me natyrën dhe qëllimin e saj të përgjithshëm shoqëror, ndaj në pjesën tjetër mbi shumën e gjykuar gjykata e refuzoi, si të pabazuar.

Mbi shumat e gjykuara, gjykata ia pranoi paditësit edhe kamatën e kërkuar në lartësinë sikundër mjetet e deponuara në bankat komerciale në kursimet e qytetarëve mbi 1 vit pa destinim të caktuar, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit e deri në pagesën definitive, sipas dispozitës së nenit 277 par.1 të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 450 të LPK-së, andaj dhe vendosi që secila palë t'i barte shpenzimet e veta.

Për këto shkaqe dhe arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i përgjithshëm
C.nr.1012/11, dt. 13.07.2020

Gjyqtarja:
Shpresa Veselaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.